



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 3355 prot.

Pogradec, më 19.08.2026

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE**

Bazuar në nenin 64 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Bashkia Pogradec do të fillojë procedurat për plotësimin vendit vakant në Qendrën Komunitare (PAK), Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si më poshtë:

- **1 ( një) pozicion- Logopedist pranë Qendrës Komunitare (PAK), Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec.**

**Qëllimi i Vendit të Punës**

Logopedisti është përgjegjës për dhënien e shërbimeve logopedike për fëmijët me aftësi të kufizuar.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1. **Identifikon** vështirësitë/çrregullimet e të folurit dhe të komunikimit dhe në varësi të tyre, harton programe individuale të shërbimit logopedist.
2. **Merr** pjesë në planin e zhvillimit të fëmijës/ familjes për fëmijët që ndiqen nga pikëpamja logopedike dhe të ofrojë këshillime për kujdestarët e fëmijëve që kanë probleme logopedike.
3. **Ndërhyn** dhe mbështet stafin në situata të caktuara për të realizuar zgjidhje sa më efikase dhe profesionale për fëmijët me probleme të të folurit.
4. **Monitoron** dhe vlerëson progresin e fëmijës.
5. **Përgatitja** dhe **vlerësimi** periodikisht i progresit për sjelljen, autonominë, komunikimin etj.
6. **Kryen** një sërë aktiviteteve të dizenuara për të zhvilluar aftësitë para gjuhësore dhe gjuhësore, kontrollin oral-motorik për shprehjen e gjuhës, vokalizimet, si dhe përdorimin e teknologjive ndihmëse në ndihmë të komunikimit.

**Kualifikimet dhe Cilësitë e Punonjësit**

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” ose “Master” në Logopedi
2. Të ketë përvojë në profesion.
3. Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
4. Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

5. Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrë profesionale dhe etike.
6. Respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes.
7. Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës

**A. Kandidatët për Logopedist duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të gjykatave shqiptare dhe/ose të huaja për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje, sipas përcaktimeve në kreun II, të pjesës së posaçme të Kodit Penal;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga detyra;
7. Të zotërojnë minimalisht nivelin e diplomës Bachelor në fushën përkatëse;

**B. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim;
- Curriculum vitae;
- Certifikatë e përbërjes familjare;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Diplomë të noterizuar (bachelor);
- Listë e notave e noterizuar;
- Librezë pune ( në qoftë se ka punuar);
- Rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm (në qoftë se ka punuar);
- Vërtetim i gjendjes mjekësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim gjykate dhe prokurorie;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë Pogradec brenda datës **07.09.2026**.

Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumenteve sjell skualifikimin e konkurrentit.

**DREJTOR I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**LAURA ELMASLLARI**

